



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Zyra për Komunikim me Publikun
Kancelarija za Javno Komuniciranje
Office of Public Communication

THIRRJE PËR APLIKIM

Për Pagesat Direkte për pulat vojëse – prodhimtaria e vezëve

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural edhe këtë vit do të mbështes fermeret mbareshtues të pulave vojëse përmes Pagesave Direkte.

Fermerët që aplikojnë duhet t'i plotësojnë këto kritere:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të mbarësojnë mbi 2,400 pula vojëse në të gjitha fazat e prodhimtarisë aktive të vezëve;
- Të dëshmojë origjinën e pulave vojëse (zogëzave);
- Të ketë certifikatën shëndetësore për gjendjen e tufës së pulave vojëse;

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
- Kopjen e certifikatës së biznesit dhe informatën mbi biznesin;
- Kopjen e certifikatës së numrit fiskal,
- Dëshmi – vërtetimin për obligimet e kryera ndaj ATK-së;
- Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë bankare të subjektit;
- Kopjen e dëshmisë për numrin dhe origjinën e pulave, fatura e furnizimit nga importuesi dhe prodhuesi;
- Certifikata veterinare-shëndetësore e lëshuar nga Praktikat veterinare të licencuara nga AUV;
- Dëshmi për pagesën e tatimit mbi pronë.

Menyra e subvencionimit:

- Subvencionimi do të bëhet për njësi/pulë vojëse në të gjitha fazat në prodhimtarinë aktive të vezëve sipas madhësisë së tufës;
- Subvencionimi bëhet vetëm për një turnus të prodhimtarisë gjatë viti kalendarik nga 1 janari deri më 31 tetor 2014, por duke marre parasysh edhe 2 muajt e fundit të viti paraprak;
- Subvencionohen vetëm zogëzat nga 18 (tetëmbëdhjetë) javë dhe pulat vojëse në të gjitha fazat e prodhimtarisë së vezëve.

Madhësia e tufës

Shuma e pagesës direkte për pulë vojëse

- Nga 2,400 deri 10,000 pula vojëse.....0.50 €/pulë vojëse
- Mbi 10,000 deri 20,000 pula vojëse.....0.40 €/pulë vojëse
- Mbi 20,000 pula vojëse.....0.30 €/pulë vojëse

Aplikimi zgjatë 30 ditë kalendarike dhe fillon prej momentit të shpalljes publike.

Aplikimi bëhet në zyret e Drejtorive Komunale për Bujqësi.

Mënyra e aplikimit:

Të gjithë fermerët fillimisht, gjatë aplikimit janë të obliguar të plotësojnë formularin për regjistrim në Regjistrin e fermerëve (vlen vetëm për fermerët të cilët nuk janë regjistruar në regjistrin e fermës deri në momentin e aplikimit), i cili është parakusht për përfitimin e mbështetjes.

Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve do të aplikohen masa ndëshkimore, duke u bazuar në nenin 31 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2014 për pagesat direkte në lëmin e bujqësisë.

Sqarim:

Dokumentacioni për aplikim duhet të dorëzohet në dy kopje dhe brenda periudhës së aplikimit. Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohet për shqyrtim.